



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043200

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05666836

KE.nr. 2533/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Mehdi Krasniqi, kundër të paditurit Beli Euro-Fol, me seli në Ferizaj, me pronar B.M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gentiana Behluli, nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik më datë 22.04.2024, me datën 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia paditësit Dogana e Kosovës, e paraqitur kundër të paditurit “Beli Euro-Fol”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit ti kompensoj dëmin material në shumën prej 160,639.32€ (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë euro e tridhjetë e dy cent), në emër të shmangies së taksës doganore prej 10% për mallin e importuar foli najloni në periudhën kohore 2008-2014, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë 22.12.2017 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- II. DETYROHET paditësi që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,504.00€ (njëmijë e pesëqind e katër euro) brenda afatit prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi Dogana e Kosovës, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj me datë 26.12.2017 ka paraqitur padi kundër të paditurit Beli Euro-Fol me seli në Ferizaj, me kërkesë për kompensimin

e dëmit në shumë prej 160,639.32€ me kamatë ligjore prej 8%, në emër të shmangies së taksës doganore prej 10% për mallin e importuar foli najloni në periudhën kohore 2008-2014.

Përfaqësuesi i paditësit në seancat e mbajtura dhe në fjalën e tij përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se nga provat e administruara, dëgjimi të dëshmitarëve është vërtetuar se i padituri si pronar i firmës Beli Euro-Fol me seli në Ferizaj me rastin e importimit të mallit foli najloni nga Gjermania duke bërë deklaram të pa saktë të mallit të importuar dhe numrit tarifor me të cilin veprim iu ka shmangur taksës doganore prej 10% për periudhën kohore 2008-2014, e cila është vërtetuar nga raporti i kontrollit të sektorit të kontrollës pas importuese të datës 26.03.2014, ky fakt është vërtetua edhe nga përgjigja e marr nga autoritet Gjermane pas kërkesës së bërë nga Dogana e Kosovës. Andaj, duke marr parasysh këtë i padituri për periudhën e lart cekur duke importuar foli najloni me numër tarifor 39155100, i është shmangur taksës doganore prej 10% me të cilin veprim paditësit i është shkaktuar dëme material në shumë prej 160,639.32€.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia ashtu që të obligohet i padituri që paditësit ti paguaj shumën prej 160,639.32€ me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri përmes të autorizuarës së saj ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe gjatë seancave dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë pasi që i padituri nga ana e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega Kamenicë me Aktgjykimin P.nr.395/14 dt.28.10.2016, është liruar nga përgjegjësia penale e që është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PA.nr.208/17 dt.05.06.2018, ku ka qenë i akuzuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit se i njëjti ka kryer vepër penale shmangie nga pagesa doganore, andaj në këtë procedurë ka theksuar se gjykata është e lidhur me aktgjykim penal kuptim nenit 14 të LPK-së, andaj në rastin konkretë i padituri është liruar pikërisht për vepër penale e cila lidhet tani me objektin e kërkesëpadiës. Andaj ka theksuar se ka qenë detyrim i paditësit që të bënë ekspertizës me të cilën të merren mostrat e mallit në rastin konkretë e cila nuk është bërë andaj ka theksuar se kodi tarifor ka qenë pikërisht për mbetje foli plastike i cili kod tarifor ka qenë në përputhje me deklarata e eksportuesit të mallit nga shteti eksportues, i cili fakt është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarit B.A. zyrtar doganor i cili ka theksuar se sa herë që është kontrolluar malli kanë konstatuar se kemi të bëjmë me mall mbeturin e jo produkt final. Njëherit ka theksuar se sipas deklaratës eksportuese të shtetit eksportues është caktuar kodi doganor, kurse dëshmitari Sh.H. me pozitën shpeditër ka theksuar se vetëm këtë kod doganor e kemi bartur në deklaratën unike doganore DUD, se kërkesëpadia e paditësit është

e pa bazuar vërtetohet edhe nga fakti se nga raporti i dorëzuar me shkrim nga paditësja nuk ka qenë në gjendje të përcaktoj sa është dëmi që pretendon paditësja që i është shkaktuar pasi që në rastin konkretë barra e të provuarit i bije paditësit.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Lista e distribuimit lëshuar nga paditësja i datës 20.05.2014; Raporti kontrollit përpiluar nga paditësi me nr. Protokolli 05.1/21 i datës 26.03.2014; Lista e distribuimit i datës 24.02.2014 përpiluar nga paditësi; Shkresa përpiluar nga paditësja nr. ref. 05.1/21 i datës 20.02.2014 me emërtim N.P.T" Beli-Eurofol"-Ferizaj; Shkresa përpiluar nga paditësja nr. ref. 05.1/21 i datës 13.05.2014 me emërtim N.P.T Beli-Eurofol"-Ferizaj; Mendim për klasifikim tarifor nr. ref. 05.1 i datës 10.02.2014 përpiluar nga paditësja; Kërkesë për tarifim nr. ref.243/13.03.2014 përpiluar nga paditësja; CMR nr. 00434431 i datës 12.03.2014; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Kamenice P.nr. 395/2014 i datës 28.10.2016; Raporti përpiluar nga paditësja me datë 14.11.2018; Shkresa e përkthyer me emërtim Zyra e Policisë Kriminale të Doganave; Ekspertiza e përpiluar nga eksperti Sh.H.1. për nevoja të lëndës P.nr. 395/2014 të Gjykatës Themelore ne Gjilan-Dega Kamenicë; Shkresa me emërtim informacioni i detyrueshëm doganor i datës 23.09.2014 e përkthyer tek përkthyesi i licencuar të bashkangjitur me 10 fotografi të formatit A4 pa ngjyrë; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PA1 nr. 208/2017 i datës 05.06.2018; Procesverbali i datës 11.09.2018 ku në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar B.B.; Procesverbali i datës 16.10.2018 ku në cilësinë e dëshmitarit janë dëgjuar B.A. dhe Sh.H..

Gjykata pas provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka vlerësuar veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe në kuptim të nenit 8 të LPK, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar.

Gjykata me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se i padituri si pronar i firmës Beli Euro-Fol ka importuar mall foli najloni nga shteti i Gjermanisë, mirëpo kontestuese ishte lloji i mallit a e ka importuar si mbetje apo si produkt final.

Gjykata me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit për pagesën e dëmit të kërkuar nga i padituri, është bazuar për faktin se paditësi nuk ka arritur ta provojë përmes provave obligimin e të paditurit për pagesën e dëmit që i është shkaktuar paditësit në emër të mos pagesë së taksës

doganore prej 10% për periudhën kohore 2008-2014, ndërsa gjykata duke u bazuar në nenin 319 të LPK-së, në bazë të së cilës secila palë ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon pretendimet si dhe nenin 322 të LPK-së në bazë të së cilës në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatoj me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit, do të përfundoj duke i aplikuar rregullat për barrën e provave.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan Dega Kamenicë P.nr.395/14 i dt.28.10.2016, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PA1.nr.208/2017 dt.05.06.2018, i padituri është liruar nga përgjegjësia penale pikërisht për periudhën kontestuese ku ka qenë i dyshuar se duke importuar mall foli najloni nga Gjermania për Kosovës ka bërë deklaram të pasaktë të mallit me të cilin veprim i është shmangur taksës doganore prej 10%.

Nga provat të cilat janë administruara është vërtetuar se i padituri pronar i firmës Beli Euro-fol me selinë Ferizaj ka importuar mall foli najloni për periudhën 2008-2014, edhe si mbetje (produkt jo final) si dhe ka importuar foli najloni si produkt final, i cili fakt është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve

Gjykata në këtë çështje ka administruar si provë procesverbalin e datës 11.09.2018 ku në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar B.B. dhe procesverbali i datës 16.10.2018 ku në cilësinë e dëshmitarit janë dëgjuar B.A. dhe Sh.H.. Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit B.B. e dhënë në seancën e dt.11.09.2018, ka konstatuar faktin se i padituri ka importuar mall foli najloni nga Gjermania për periudhën kontestuese me dy numra tarifor si produkt final me numër tarifor 38201081 dhe mbetje me numër tarifor 39151000, kurse llogaritja e dëmit është bërë duke mos e zbritur edhe pjesën tjetër të cilën i padituri e ka importuar si produkt final e i cili mall i është nënshtruar taksës doganore prej 10%, respektivisht nuk është marr për bazë rastet kur i padituri ka importuar mall të produktit final, por vetëm duke llogaritur sasinë e mallit të importuar me periudhën kohore 2008- 2014 ku dhe kanë konstatuar se i padituri i ka shkaktuar dëme material paditësit në shumë prej 160,639.32€.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.A. zyrtar doganor, shef i pikës së Doganës Dheu i Bardhë, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike se sipas vlerësimeve të zyrtarëve doganor malli që e ka importuar i padituri ka qenë mbetje e jo produkt final, përjashtimisht një rasti ku malli që ka qenë në maune është dyshuar që është produkt final por nuk ka rezultuar pasi që nga përgjigja e marr nga autoritet Gjermane ka rezultuar se është mbetje pasi që ato rollne kanë qenë të dëmtuara, nga i cili dëshmitar gjykata ka kuptuar e numri tarifor i mallit me të cilit do të vërtetohej me rastin e

zhdoganimit se a kemi të bëjmë me produkt final apo të mbetur vendoset nga shteti eksportues i cili numër tarifor me rastin e zhdoganimit të mallit bartet nga ana e importuesit- shpeditërit dhe si i tillë është unik në tërë botën.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit SH.H., ka vërtetua faktin se si shpeditëri e ka bërë përgatitjen e dokumentacionit për zhdoganimin e mallit të cilin e ka importuar i padituri dhe i njëjti me rastin e rregullimit të dokumentacionit e ka vendosur numrit tarifor që e ka lëshuar vendi eksportues, në DUD, si dhe është vërtetuar edhe fakti se i padituri ka pasur raste kur ka importuar produkt final në periudhën kontestuese.

Meqenëse nga dëshmia e dëshmitarëve ka qenë kontestuese lloji i mallit, pasi që ka pasur raste që në periudhën kontestuese i padituri ka importuar edhe mall foli najloni si produkt final por edhe si mbetje, sasia për periudhën kohore gjykata në seancën e datës 11.09.2018, e ka obliguar paditësen që të sjellë një raport financiar me të cilën do të vërtetohej me saktësi se sa është dëmi që pretendon se i padituri i ka shkaktuar dëme material, nga raporti i përpiluar nga ana e paditësit e dt.14.11.2018, rezulton se paditësja nuk ka qenë në gjendje që të konstatojë se sa është dëmi që eventualisht i padituri ia ka shkaktuar paditësit si rezultat i mos pagesë së taksë doganore prej 10%.

Andaj meqenëse nga raporti i dt.14.11.2018, ka rezultuar se i padituri në 53 pozicione mallin e importuar është tarifuar me kodin doganor 3920 që i nënshtrohet taksës së doganës dhe TVSH-së, në këtë raport specifikohet se paditësja nuk ka qenë në gjendje që llogarisë me saktësi që për periudhën kontestuese sa është dëmi që i është shkaktuar në rastet kur është dyshuar që i padituri ka importuar mall si mbetje duke mos e llogaritur edhe mallin e importuar si produkt final, i cili i është nënshtuar taksë doganore prej 10%, dhe nuk mundet dy herë të ngarkohet me këtë taksë dhe paditësja me rastin e dorëzimit të raportit fillestar nuk e ka marr për bazë këtë rrethanë ku e ka specifikuar shumën prej 160,639.32€, pasi që nga provat e administruara në rastet kur është dyshuar se i njëjti ka dashur që ti shmanget taksë doganore prej 10% malli që e ka importuar ka rezultuar që të jetë mbetje i cili mall lirohet nga taka doganore prej 10% e jo produkt final i cili fakt është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarit B.A. kurse në anën tjetër pala paditëse nuk ka qenë në gjendje të siguron ndonjë provë materiale me të cilën do të bindej gjykata, ku për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat për barrën e provave, në rastin konkret gjykata ka konsideruar se paditësja nuk kanë arritur që të provojë pretendimet e saj në raport me të paditurin, andaj edhe është refuzuar kërkesëpadia.

Gjykata meqenëse deri te mënyra e vendosjes ka ardhur duke konstatuar se barra e provës i bije paditësit që ti siguron provat materiale, por duke marr për bazë që i padituri për periudhën kontestuese ku është dyshuar se ka kryer veprën penale, dhe në rastin konkretë ekziston lidhja kauzale në mes çështjes paraprake që është zhvilluar në procedurë penale ku i padituri me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga përgjegjësia penale dhe objektit të kërkesëpadisë, por me nenin 14 të LPK-së, gjykata vendimin e saj do ta bazonte në rastet kur i padituri eventualisht do të shpallej fajtor për veprën penale e jo në rastin konkretë që i njëjti është liruar nga përgjegjësia penale.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh gjithnjë pretendimet tjera të paditësit në lidhje me këtë çështje kontestimore por nga provat të cilat janë administruara nuk ka pasur bazë për të vendosur ndryshe, për dallim të asaj që ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke e obliguar paditësen që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,504€, dhe atë për përgjigje në padi 154€, për 5 seanca të mbajtura nga 270€, gjithsejtë 1.350€, kurse pjesa tjetër është refuzuar si e pa bazuar pasi që shuma e njëjta e shpenzimeve është i është njohur të paditurit edhe me aktgjykimin paraprak ndaj të cilit i padituri nuk ka paraqitur ankesë.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2533/22, datë 07.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.